



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr. 7 , datë 28/03/2023

PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR  
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK”,  
SHOQËRISË “IDROLUSA” SH.P.K.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Mat,

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes “Për përdorim të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik”, shoqërisë “IDROLUSA” sh.p.k., me vendndodhje, në pellgun ujëmbledhës të përroit të Lusës, degë të lumit Mat, HEC “Lusa 1” dhe “Lusa 2”, në Bashkinë Klos, Qarku Dibër, sipas këtyre koordinatave:

Treguesit paraprak janë si më poshtë:

**HEC “LUSA 1”**

Vepra e marrjes 1:

- X= 517252.7
- Y= 4604679.6

- $Z=1721$  m.m.n.d
- $Q_{mes}=0.214$  m<sup>3</sup>/s
- $Q_{llog}=0.223$  m<sup>3</sup>/s
- $Q_{eko}=0.037$  m<sup>3</sup>/s

Vepra e marrjes 2:

- $X= 517483.3$
- $Y= 4604970.8$
- $Z=1721.35$  m.m.n.d
- $Q_{mes}=0.033$  m<sup>3</sup>/s
- $Q_{llog}=0.09$  m<sup>3</sup>/s
- $Q_{eko}=0.015$  m<sup>3</sup>/s

Godina e Centralit:

- $X= 514430.4$
- $Y= 4605794.8$
- $Z=1090$  m.m.n.d
- Fuqia e instaluar  $N= 1,600$  kWh
- Energjia mesatare Vjetore  $E=5,829,513$  kWh/vit.

**HEC “LUSA 2”**

Vepra e marrjes 1:

- $X= 514501.3$
- $Y= 4605827.5$
- $Z=1090$  m.m.n.d
- $Q_{mes}=0.63$  m<sup>3</sup>/s
- $Q_{llog}=0.846$  m<sup>3</sup>/s
- $Q_{eko}=0.133$  m<sup>3</sup>/s

Vepra e marrjes 2:

- $X= 514017.9$
- $Y= 4605465.3$
- $Z=1095$  m.m.n.d
- $Q_{mes}=0.095$  m<sup>3</sup>/s
- $Q_{llog}=0.126$  m<sup>3</sup>/s
- $Q_{eko}=0.02$  m<sup>3</sup>/s

Godina e Centralit:

- $X= 509609.6$
- $Y= 4604804.3$

- Z=500 m.m.n.d
  - Fuqia e instaluar N= 4,600 kWh
  - Energjia mesatare Vjetore E=16,564,386 kWh/vit.
2. Zbatimi i kontratës koncesionare nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbytjes së vendimit subjektivit.

**KRYETARI I KBU MAT**

**GJERGJ PRENDI**

